



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndertesë e “Fakultetit Teknik”, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: [fn@uni-pr.edu](mailto:fn@uni-pr.edu)

Ref. nr. 4665/1 Prishtinë 05.12. 2022

## PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

### DEPARTAMENTI KONSTRUKTIV

Studenti Valentrim Bajrami ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: “ **Projektimi i objekteve muraturë sipas standardeve europiane të strukturave, Analiza e objekteve në zonatsizmike** ” në programin e studimeve Master Konstruktiv dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullore për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

## ABSTRAKT

Duke marrë parasysh rëndësinë e strukturave muraturë, të cilat zënë vend të konsiderueshëm në ndërtimet ekzistuese të cilat janë ndërtuar përgjatë kohëve të ndryshme. Strukturat muraturë mund të ndërtohen në zona me ndikime të veprimeve të jashtme siç është intensiteti përkatësisht shpejtësia e erës, pastaj veprimet sizmike, është me interes që të bëhen studime dhe analiza të ndryshme rreth këtyre strukturave me qëllim të vlerësimit të rezistencë së tyre si dhe të vlerësojmë kapacitetin sizmik dhe reagimin e objekteve të reja dhe ekzistuese gjatë një veprimi të tërmetit. Duke trajtuar dhe analizuar objektet muraturë çfarë kemi edhe në vendin tonë mund të nxjerrim komente dhe konkluzione me interes.

Ky punim përmban pjesën teorike dhe analitike. Punimi përbëhet prej 7 kapitujve. Në pjesën e parë teorike janë përshkruar në pika të shkurta historia dhe zhvillimi i strukturave muraturë përgjatë historisë, materiale përbërëse në muraturë, cilësitë mekanike të strukturave murature, veprimi dhe shkaktimi i dëmtimeve nga tërmeti në strukturat muraturë, standardet evropiane të projektimit për strukturat muraturë dhe në fund projektimi dhe llogaritja e strukturave muraturë sipas standardeve evropiane të projektimit.

Në kuadër të pjesës teorike gjithashtu janë dhënë principet themelore për llogaritjen të strukturave muraturë sipas EN 1996 si dhe llogaritjen në zonat sizmike të strukturave murature sipas EN 1998. Pjesa e dytë përmban pjesën analitike/numerike ku është analizuar një objekt muraturë me etazhitet P+4. Në të cilin janë bërë llogaritjet sipas EN 1998 për strukturat muraturë ku janë bërë analiza e ngarkesave, veprimet sizmike, caktimi i masës dhe shtangësisë së objektit, kriteret për rregullsi strukturore, faktori i sjelljes, analiza modale, zhvendosjet relative ndërmjet kateve dhe efektet (P-Δ) dhe dimensionin e murit 1 sipas EN 1996. Analiza e objektit është bërë me programin për analiza strukturore ETABS. Ndërsa analiza jo lineare (analiza Pushover) është bërë me anë të programit të specializuar për strukturat muraturë 3muri.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.